1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet te paraqese dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar për shërbimet e mëparshme duhet të jetë sa 40% të Vlerës limit e kontratës që prokurohet (Vlera e parashikuar e Marrëveshjes Kuadër per 12 muaj) të Lotit 1 dhe që janë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit. Per kete OE duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë dhe paraqesë **Licenca profesionale** per aktivitetin qe ushtron si më poshtë :

- Për realizimin e zërave te riparimeve dhe shërbimeve, objekt i kontrates, Operatori Ekonomik duhet te jete i paisur me liçense profesionale, (Referuar VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, sipas kategorive të mëposhtme, :
 - a) NS-12 A (Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit);
 - b) NS-14A (Impiante të brendshme elektrike, etj);

3. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i certifikuar dhe paraqesë **Çertifikata kualifikimi për menaxhimin** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë :

- 1) Çertifikaten per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001 : 2008
- 2) Çertifikaten per sistemin e menaxhim të shëndetit dhe sigurise në punë OHSAS 18001 : 2007
- 3) Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2004

4. Operatori ekonomik duhet të kete në përberje te stafit, minimalisht punonjësit si me poshte: Për ofrimin e shërbimit, diagnostifikimin e difekteve dhe riparimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike, operatori ekonomik duhet të ketë **minimalisht 8 punonjes me profesionet si me poshtë:**

- Ing.Mekanik 1 person
- Ing.Elektrik 1 person
- Ing.mjedisi 1 person
- Teknik per sistem ngrohje ftohje/kondicioner 4 persona
- Elektricist 1 person

Në lidhje me kërkesën në pikën 4, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentat si me poshte:

- Deklaratë me listen e punonjesve me profesionet perkatese që ushtrojnë, përfshirë të gjitha profesionet e kërkuara nga AK, kodet e te cilave do te verifiohen ne listepagesa.
- Per inxhinieret të paraqiten diplomat dhe kontrata e punës përkatëse.
- Per personelin tjetër teknik te paraqiten deshmi të kualifikimit ose të formimit profesional, që vërtetojnë profesionet e tyre dhe kontratat e punës përkatëse..
- Listepagesat e sigurimeve shoqerore te deklaruarra përmes formës elektronike prane organeve tatimore, per çdo muaj per periudhen Janar 2018 – Prill 2018, ku të jenë të pasqyruar punonjesit me profesionet perkatese sipas deklaratës, shoqëruar me Vërtetimin për numrin e punonjësve të siguruar për këtë periudhë, të lëshuar nga administrata tatimore.

5. Në zbatim të ligjit Nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht një punonjës, pjesë e stafit duhet te jete i pajisur me certifikate trajnimi per menaxhimin e sigurise dhe shendetit te punonjesve. Për këtë të paraqitet certifikata e trajnimit.

6. Me qëllim sigurimin e furnizimit të pjesëve të këmbimit të kërkuara sipas Lotit 1, Operatori Ekonomik duhet të ketë në objektin e veprimtarisë së tij në ekstraktin e QKB, edhe veprimtarinë e importit ose të tregtisë së pjeseve te kembimit.

Ne rastin kur nuk e ushtron veprimtarine e importit ose te tregtise se pjeseve te kembimit, duhet të paraqesë marreveshje furnizimi të lidhur me një subjekt që ushtron veprimtarine e importit ose tregtise se pjeseve te kembimit.

AK do te verifikojë në ekstraktin e QKB, fushen e aktivitetit të OE,/ ose / të Subjektit me te cilin

ka lidhur Marrveshje.

7. OE të paraqesë Deklarate se pjeset e kembimit qe do te perdoren, do te jene te reja, origjinale, prodhim sipas standarteve te CE, dhe për garancinë e pjesëve të kembimit jo me pak se 1vit, nga data e montimit.

8. Duke patur parasysh se ndertesa është godinë pesë katëshe, operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht nje automjet tip vinç, në pronësi të tij ose me qëra të vërtetuar me dokumentacionin përkatës si më poshtë:

a). Në rastin kur mjete është në pronësi të paraqitet dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).

b). Per rastin kur automjeti është me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates shoqeruar me dokumentin qe verteton rregjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin, (te vlefshme)

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI 2: MIREMBAJTJE RIPARIM DY ASHENSORET

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

b. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri (Ku te perfshihet edhe muaji Mars 2018).*

c. *Deklarate per permbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5*

d. *Formularin e Ofertes - Shtojca 1 (plotesuar me zërat e parashikuara, cmimet njesi, sasite e parashikuara dhe vlerën totale sipas Lotit 2 për të cilin oferton)*

2. Për të provuar përmbushjen minimale te kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

Sipas kriterëve të Përgjithshme

2.3 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.4 a). Operatori ekonomik duhet te paraqesë Vertetim nga administrata tatimore per xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit 2015-2016-2017. Vlera e xhiros mesatare vjetore gjate tre viteve te fundit, duhet të jetë sa Vlera limit e kontratës që prokurohet (Vlera e parashikuar e Marrëveshjes Kuadër per 12 muaj) të Lotit 2 për të cilin oferton.

2.3 Për kapacitetin teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet te paraqese dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar për shërbimet e mëparshme duhet të jetë sa 40% të Vlerës limit e kontratës që prokurohet (Vlera e parashikuar e Marrëveshjes Kuadër

per 12 muaj) të Lotit 2 për të cilin oferton dhe që janë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Per kete OE duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të kete në përberje te stafit, minimalisht punonjësit si me poshte:

Për ofrimin e shërbimit, diagnostifikimin e difekteve dhe riparimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike, për Lotin 2, operatori ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit, minimalisht 3 punonjës me profesionet si me poshte:

- Ing.Mekanik 1 person
- Teknik Mekanik 2 persona

Në lidhje me kërkesën në pikën 2, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentat si me poshte:

- Deklaratë me listen e punonjesve me profesionet perkatese që ushtrojnë, përfshirë të gjitha profesionet e kërkuara nga AK, kodet e te cilave do te verifiohen ne listepagesa.—

- Per inxhinieret të paraqiten diplomat dhe kontrata e punës perkatese.

-Per personelin tjetër teknik te paraqiten deshmi të kualifikimit ose të formimit profesional, që vërtetojnë profesionet e tyre.

- Listepagesat e sigurimeve shoqerore te deklaruarra përmes formës elektronike prane organeve tatimore, per çdo muaj per periudhen Janar 2018 – Prill 2018, ku të jenë të pasqyruar punonjesit me profesionet perkatese sipas deklaratës, shoqëruar me Vërtetimin për numrin e punonjësve të siguruar për këtë periudhë, të lëshuar nga administrata tatimore.

Public Health Sector

3. Me qëllim sigurimin e furnizimit të pjesëve të këmbimit të kërkuara sipas Lotit 2, Operatori Ekonomik duhet të ketë në objektin e veprimtarisë së tij në ekstraktin e QKB, edhe veprimtarinë e importit ose të tregtisë së pjeseve te kembimit.

Ne rastin kur nuk e ushtron veprimtarine e importit ose te tregtise se pjeseve te kembimit, duhet të paraqesë marreveshje furnizimi të lidhur me një subjekt që ushtron veprimtarine e importit ose tregtise se pjeseve te kembimit.

AK do te verifikojë në ekstraktin e QKB, fushen e aktivitetit të OE,/ ose / të Subjektit me te cilin ka lidhur Marrveshje.

4. OE të paraqesë Deklarate se pjeset e kembimit qe do te perdoren, do te jene te reja, origjinale, prodhim sipas standarteve te CE, dhe për garancinë e pjesëve të kembimit jo me pak se 1 vit, nga data e montimit.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

SQARIM

PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT:

- Nëse një operator ekonomik konkurron në më shumë se 1 lot të kësaj procedure prokurimi atëherë ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedurës së prokurimit, pra të gjitha lotetë së bashku. Në këtë kuptim edhe kriteret e veçanta për kualifikim (si p.sh kontratat e ngjashme, xhiro., etj) duhet të plotësohen nga operatori ekonomik në varësi të lotetë që ai konkurron.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

PËRCAKTIMI I SHËRBIMEVE DHE PJESËVE TË KËMBIMIT

Planifikimi i zërave të shërbimeve, pjesëve të këmbimit dhe sasive orientuese është bërë mbështetur në nenin 45/1, pika 2 e VKM 914, datë 29.12.2014, e ndryshuar. Në përcaktimin e zërave është patur parasysh gjendja aktuale teknike, kërkesat periodike për shërbimet sipas përcaktimeve teknike. Sasitë e dhëna në tabelat bashkëlidhur, për secilin lot, janë vetëm

orientuese. Zerat dhe sasite orientuese janë percaktuar duke marre parasysh mundesine e ndodhjes se difekteve gjatë periudhës së Marrveshjes Kuadër.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

I. Lot.1 Mirembajtje sistemi i kondicionimit

Në godinën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëmbajtjes Sociale, janë të instaluar kondicionerët si më poshte:

Nr.	Tipi	Sasia copë
1	Gree	6
2	M.Elektrik	1
3	Skytec	7
4	Fuego	10
5	Kond	5
6	Carrier	3
7	Nordstar	1
8	Fujitsu	1
9	Maselino	1
10	Hyundai	2
11	Sanyo	1
12	Neo	1
13	Midea	7
	Totali	46

Gjithashtu janë të instaluar :

Nr.	Tipi	Kapaciteti	Sasia copë
1	Chiller për sallën e mbledhjeve	12-13.5kw	1
2	Chiller për kabinetin	14.8-15.9kw	1
3	Chiller kati i V- të	10.92-13.55kw	1

Shërbimi përfshin kontrollin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit të aspirimit dhe kondicionimit, dhe të kondicionerëve për një periudhë 12 muaj, me qëllim funksionimin e tij në përputhje me kushtet e sigurisë dhe parametrat teknike të percaktuara nga prodhuesi.

Tabela1

Lot.1 Mirembajtje sistemi i kondicionimit

Zërat e parashikuara të riparimeve jepen në tabelen si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia e parashikuar
1	Kontroll i presionit dhe mbushje me gaz R407 & R410A per kondicionere 9000/12000/18000 btu/h	kg	92

Dokumentat Standarde të Tenderit

2	Pastrim dhe larje filtra kondicionereve 9000/12000/18000 btu/h 4(kater) here ne vit cdo tre muaj	copë	184
3	Cmontim Furnizim Montim Pakete kondicioneri 9000 btu/h	copë	10
4	Cmontim Furnizim Montim Pakete kondicioneri 12000btu/h	copë	3
5	Cmontim Furnizim Montim Pakete kondicioneri 18000 btu/h	copë	1
6	Cmontim Furnizim Montim helike kondicioneri 9000/12000 btu	copë	5
7	Cmontim Riparim Montim pakete kondicioneri 9000/12000/18000 btu	copë	10
8	Cmontim Furnizim Montim Elektrovalvol tre rrugshe kondicioner 9000/12000 /18000 btu/h	copë	10
9	Cmontim Furnizim Montim Kondesator 30 mikro farad 9000/12000 /18000 btu/h	copë	10
10	Cmontim Furnizim Montim Kondesator 60 mikro farad 9000/12000 /18000 btu/h	copë	10
11	Zmontim Avolzhim Montim motorr kompresori kondicioneresh	copë	10
12	Cmontim Furnizim Montim kompresor 9000btu/h	copë	4
13	Cmontim Furnizim Montim kompresor 12000btu/h	copë	2
14	Pastrim dhe larje serbetina fankoila me solucion 4(kater) here ne vit , cdo tre muaj	copë	72
15	Kontroll i presionit te gazit, filtrit te ujit dhe te gazit dhe te komponenteve elektrik te Chillerave	here	3
16	Cmontim Furnizim Montim filter uji per chiller (12-13.5kw; 14.8-15.9kw; 10.92-13.55kw)	copë	3
17	Cmontim Furnizim Montim Pompe uji per chiller	copë	1
18	Riparim Pompe uji per chiller (12-13.5kw; 14.8-15.9kw; 10.92-13.55kw)	copë	3
19	Cmontim Furnizim Montim Termostat elektronik me komande ne distance per fancoila 3.5-4.2 kW	copë	6
20	Cmontim Furnizim Montim Automate 16 A	copë	8
21	Cmontim Furnizim Montim Automat termo elektro magnetik 4P;380V;40A	copë	1
22	F/V Kabell 3x2.5mm	ml	140
23	F/V Prize shuko jashte murit 2P+T IP=54 Gevis	copë	6
24	F/V Prize shuko jashte murit 2P+T IP=54 Vimar	copë	5

Zerat e riparimit dhe sasite e dhena jane te parashikuara, orientuese dhe jo detyruese. AK do te kryeje sherbimin e mirembajtjes profilaktike per pastrimin, larjen e filtrave te kondicionereve dhe serpentinave te fankoilave cdo tre muaj. Kontrolli i presionit te gazit dhe mbushja me gaz sipas nivelit te kerkuar, do te jete sipas nevojave. Kontrolli i chillerave dhe sistemit te tyre, sherbimet e mirembajtjes preventive te tyre jane parashikuar nje here ne kater muaj.

Riparimet e tjera dhe zevendesimi i pjeseve te kembimit do te kryhet sipas nevojave, vetem ne rast difekti, sipas zerit dhe sasise se nevojshme.

a) Në zërin kontroll, pastrim, shërbim mirëmbajtje profilaktike parashikohen:

- Hapja e chillerave, pastrimi me solucion, pastrimi i filtrit të ujit dhe të gazit, kontroll i presionit te gazit, cdo 4 muaj.
- Pastrim dhe larje me solucion i filtrave të fan-coil-ve, cdo 4 muaj.
- Pastrim dhe larje me solucion i filtrave të kondicionereve, cdo tre muaj.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Kontrolli i presionit dhe mbushje me gaz e kondicionerëve, sipas kërkeses.
 - Kontroll pompa e ujit.
 - Kontroll tubacione, valvola, rakorderi, eliminim rrjellje uji.
 - Kontroll paneli elektrik
- b) Kontroll teknik sa here të jetë e nevojshme për konstatimin e difektit të shfaqur. Ky shërbim do të jete pa pagese dhe do të ofrohet nga operatori ekonomik në funksion të shërbimit të mirëmbajtjes së përgjithshme.
- c) Riparimet e tjera dhe zëvendësimi i pjesëve të këmbimit, janë të parashikuara. Ato do të kryhen vetem në rastet kur do të konstatohen difektet ose do të jetë i nevojshëm riparimi apo zëvendësimi i tyre, bazuar në orët e punës.
- d) Pjesët që do të zëvendësohen duhet të jene prodhim original dhe të plotësojnë standartet CE. Në cdo furnizim të kërkuar, pjesët e këmbimit duhet të jenë me paketimin origjinal të shoqëruara me skedën teknike ose flete palosjen.

II. Lot.2 Mirembajtje riparim dy ashensorë

Në godinën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëmbajtjes Sociale, janë të instaluar dy ashensorë.

- 1- Ashensori 5 katësh është prodhim CE , me 5 ndalesa, me kapacitet 5.5 kw
- 2- Ashensori 3 katësh është prodhim CE , me 3 ndalesa, me kapacitet 5.5 kw

Shërbimi përfshin kontrollin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ashensorëve, për një periudhë 12muaj, me qëllim funksionimin e tyre në përputhje me kushtet e sigurisë dhe parametrat teknike të përcaktuara nga prodhuesi.

Public Health Sector

Tabela 2

Lot.2 Mirembajtje riparim dy ashensorë

Zërat e parashikuara të riparimeve jepen në tabelen si më poshtë:

Nr	Zerat e shërbimit	Njesia	sasia e parashikuar
1	Kontroll,shërbim mirembajtje profilaktike cdo muaj	Here	12
2	FV Skede Kryesore e komandimit te ashensorit ML60X	Cope	1
3	FV Skeda e emergjences kur nderpriten dritat MLKS10-S	Cope	1
4	FV Skede e komunikimit serial MLS60-X	Cope	1
5	FV Skede e kontrollit te deres se kabines MLD-XL.10	Cope	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

6	FV Skede e Alarmit MLREV-X	Cope	1
7	FV Encoder incremental 1024REV	Cope	1
8	FV Elektromotor i operatorit te deres 24VDC	Cope	1
9	FV Rrip I dhembezar I operatorit te kabines	Cope	1
10	FV Rotela mbajtese te deres	Cope	2
11	FV Rotela ekscentrike per rregjistrimin e deres	Cope	2
12	FV Guida plastike (patina) te deres	Cope	2
13	FV Fotocelele ELC35En81-20	Cope	1
14	FV Transformatori i panelit 220 -24,190,50	Cope	1
15	FV Buton komandimi ashensori	Cope	2
16	FV Tregues kati(Display)	Cope	3
17	FV Leshues elektromekanik I Fuqise	Cope	2
18	FV Impulsore MOIF	Cope	2
19	FV Gomine centruese e arkates se kabines	Cope	2
20	FV Kavore e operatorit te deres se kabine	Cope	2
21	FV Kavore celiku $\Phi 6$ e limitatorit te shpejtesise	Meter	2
22	Vaj Motori	Liter	6
23	FV Guida plastike per udhezimin e kabines	Cope	2
24	FV Guida plastike per udhezimin e kondrapeshes	Cope	2

- a) Në zërin kontroll shërbim mirëmbajtje profilaktike cdo muaj, janë parashikuar:
- Shërbimi periodik në dhomën e makinerisë, kontrolli i pjesëve mekanike dhe elektrike.
 - Kontrolli i sistemeve dhe mekanizmave të mbrojtjes, frenimit, komandimit, të lëvizjes, dyert, kavot etj.
 - Rregjistrimi i frenave , i dyerve , i operatorit të derës etj.
 - Pastrimi, vajtja dhe lubrikim i shinave dhe gjithë nyjeve lëvizëse, kontrolli i rrjedhjeve etj.
 - Kontroll i sigurisë , sinjalizimit, ndricimit, izolimeve dhe tokëzimeve.
 - Testim i sistemit të emergjencës.
- b) Riparimet e tjera dhe zëvendësimi i pjesëve të këmbimit, janë të parashikuara dhe do të kryhen vetëm në rastet kur do të konstatohen difektet dhe do të jetë i nevojshëm riparimi apo zëvendësimi i tyre.
- c) Pjesët që do të zëvendësohen duhet të jene prodhim original dhe të plotësojnë standartet CE. Në cdo furnizim të kërkuar, pjesët e këmbimit duhet të jenë me paketimin origjinal të shoqëruara me skedën teknike ose flete palosjen.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi të sistemit të kondicionimit dhe të ashensoreve të MSHMS, me 2 lote. Marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, me disa OE, si më poshtë:

- **Lot.1 Mirembajtje sistemi i kondicionimit (MK me nje OE)**
- **Lot.2 Mirembajtje riparim dy ashensoret (MK me nje OE)**

Afatet e ekzekutimit:

Afati: 12 muaj nga data e lidhjes së Marrveshjes Kuadër

- Me qëllim sigurimin e vijueshmerisë së shërbimit.
- Me qëllim marrjen e masave profilaktike të shërbimit të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve



Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi të sistemit të kondicionimit dhe të ashensoreve të MSHMS, me 2 lote. Marrveshje kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, me disa OE, si më poshtë:

- **Loti 1: Mirembajtje sistemi i kondicionimit (MK me nje OE, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara)**

- **Loti 2: Mirembajtje riparim dy ashensorët (MK me një OE, ku të gjitha kushtet janë të percaktuara)**

KËRKESAT PËR SHËRBIMIN

Loti 1: Mirembajtje sistemi i kondicionimit

Operatori duhet të kryejë kontrole të përgjithshme për pastrimin, kolaudimin, mirëmbajtjen profilaktike sipas zërave të parashikuara, me qëllim funksionimin e sistemit në përputhje me kushtet e sigurisë dhe parametrat teknike të percaktuara nga prodhuesi.

- a). Operatori duhet të hartojë grafikun e shërbimeve të planifikuara të mirëmbajtjes profilaktike dhe tja verë në dispozicion Sektorit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme.
- b). Operatori duhet të mbajë librin e shërbimeve profilaktike të kryera, ku të pasqyrohen shërbimet e kryera, pjesët e zëvendësuara ose të riparuar, data, ora dhe emrat e punonjësve të shërbimit. Ky liber i vihet në dispozicion Sektorit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme.
- c). Riparimet e tjera janë të parashikuara, por do të kryhen vetëm në rast difekti, me kërkesën e Autoritetit Kontraktor. Në çdo rast do të lidhen kontrata bazuar në Marrveshjen Kuadër.
- d). Operatori Ekonomik është i detyruar të përgjigjet menjëherë kërkesës së Autoritetit Kontraktor, duke siguruar riparimin e difektit në kohë dhe me cilësi.
- e). Operatori Ekonomik është i detyruar të kryejë kontroll sa herë të jetë e nevojshme për konstatimin e difektit të shfaqur. Ky shërbim do të jete pa pagesë dhe do të ofrohet nga operatori ekonomik në funksion të shërbimit të mirëmbajtjes së përgjithshme.

Loti 2: Mirembajtje riparim dy ashensorë

- a) Operatori duhet të kryejë shërbimin e kontrollit dhe mirëmbajtjes profilaktike çdo muaj për të garantuar funksionimin e ashensorëve në përputhje me kushtet e sigurisë dhe parametrat teknike të percaktuara nga prodhuesi.
- b) Operatori duhet të hartojë grafikun e shërbimeve të planifikuara të mirëmbajtjes profilaktike dhe tja verë në dispozicion Sektorit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme.
- c) Operatori duhet të mbajë librin e shërbimeve të ashensorit, ku të pasqyrohen shërbimet e kryera, pjesët e zëvendësuara ose të riparuar, data, ora dhe emrat e punonjësve të shërbimit. Ky liber i vihet në dispozicion Sektorit të Shërbimeve Mbeshtetëse.
- d) Riparimet e tjera janë të parashikuara dhe do të kryhen vetëm në rast difekti, me kërkesën e Autoritetit Kontraktor, sa herë të jete e nevojshme. Në çdo rast do të lidhen kontrata bazuar në Marrveshjen Kuadër.
- e) Operatori Ekonomik është i detyruar të përgjigjet menjëherë kërkesës së Autoritetit Kontraktor, duke siguruar riparimin e difektit në kohë dhe me cilësi.
- f) Operatori Ekonomik është i detyruar të kryejë kontroll sa herë të jetë e nevojshme për konstatimin e difektit të shfaqur. Ky shërbim do të jete pa pagesë dhe do të ofrohet nga operatori ekonomik në funksion të shërbimit të mirëmbajtjes së përgjithshme.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Operatori Ekonomik është i detyruar të kryejë kontroll sa herë të jetë e nevojshme për konstatimin e difektit të shfaqur. Ky shërbim do të jete pa pagesë dhe do të ofrohet

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes Sociale



Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 13



[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme: _____

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Public Health Sector

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Dokumentat Standarde të Tenderit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat Standarde të Tenderit

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 15.

Public Health Sector KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose

njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.

- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
